

# Sh.M.Q.Sh "SARAJ"- SHKUP

## Raporti vjetor



### RAPORTI VJETOR PËR PUNËN E SHKOLLËS SË MESME TË QYTETIT TË SHKUPIT "SARAJ" – SHKUP PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021

Gusht , 2021

Në bazë të nenit 116 të Statutit të shkollës ShMQSh “Saraj” - Shkup, Këshilli i shkollës në mbledhjen e mbajtur më 27.08.2021, miratoi këtë

## **VENDIM**

### **Për të miratuar raportin e ShMQSh „Saraj“ – Shkup për vitin shkollor 2020/2021**

1. Miratohet Raporti i punës i ShMQSh“ Saraj“ - Shkup për vitin shkollor 2020/2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.
3. Një kopje e vendimit i dërgohet Qytetit të Shkupit- Departamenti për Arsim dhe Arkivit.

**KRYETAR I KËSHILLIT TË SHKOLLËS  
TË SHMQSH“ SARAJ“-SHKUP**

---

**Arlind Bakiu**

Të dhënat bazë të shkollës .....	4
Përshkrim i shkurtër historik për ekzistencën, zhvillimin dhe funksionimin e shkollës.....	Error! Bookmark not defined.
Kushtet hapësinore për punë në shkollë .....	7
Kushtet materialo-teknike për realizimin e punës edukativo arsimore .....	8
Stafi arsimor .....	9
Nxënësit në vitin e fundit kanë dhënë provimin e maturës shtetërore dhe provim përfundimtar për arsimin profesional.....	11
Kushtet materiale - teknike .....	13
Bashkëpunimi .....	14
Aktivitetet .....	15
Projektet e dramës:.....	15
Ekskursionet .....	16
Puna shoqërore e dobishme dhe për të promovuar shëndetin e nxënësve .....	16
Aktivitetet e bashkësisë së nxënësve të shkollës.....	16
Suksesi i përgjithshëm i nxënësve në fund të vitit.....	
shkollor 2020/2021.....	21
<b>SUKSESI I VITEVE TË I-RA,II-TA DHE TË III-TA NË FUND TË VITIT TË PARË TË VITIT SHKOLLOR 2020/21 .....</b>	<b>21</b>

## Letërnjoftimi i shkollës : -

Emri i institucionit	ShMQSh "Saraj" Shkup
Adresa, komuna, vendi	Rr. "2" nr.20, Saraj, Shkup
Telefoni	02 511 0127
E-mail	<a href="mailto:Saraj_Shkup@yahoo.com">Saraj_Shkup@yahoo.com</a>
Themeluar nga	Kuvendi i Qytetit të Shkupit
Verifikimi – numri i aktit	12-777
Viti i verifikimit	05.05.2016
Gjuha në të cilën realizohet procesi mësimor	Gjuhë shqipe
Viti i ndërtimit	2016
Lloji i ndërtimit	Ndërtim i fortë
Sipërfaqja e objektit	1500 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e oborrit të shkollës	3500 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e terreneve sportive	1176 m <sup>2</sup>
Salla sportive	1550 m <sup>2</sup>
Mënyra e ngrohjes së shkollës	Derivate të naftës
Numri i paraleleve	24
Numri i ndërrimeve	2
Statusi i eko shkollës (flamuri i gjelbër, i argjendtë ose i bronzë)	i gjelbër

## Lokacioni i shkollës:

Shkolla gjendet në territorin e komunës Saraj në afërsi të Qendrës Tregtare Saraj, për këtë lehtë mund të gjendet nga nxënësit , prindërit dhe të tjerët të interesuar nga regjioni dhe më gjerë. Qasja deri te shkolla është e rregulluar me transport me autobus nga të gjitha lagjet e qytetit dhe lagjeve përreth.

## **Përshkrim i shkurtër historik për ekzistencën, zhvillimin dhe funksionimin e shkollës**

Kërkesat e kahëmotshme, arsimit, vizioni, misioni, bashkëpunimi, brezat e ardhshëm të suksesshëm janë vetëm disa nga vlerat që përshkruhen pas emrit të shkollës së mesme " Saraj " e cila funksionon përkatësisht punon që një vit mësimor.

Me që komuna Saraj ka 35.804 banorë që ka qenë ëndërr e kahëmotshme që të kenë një shkollë të mesme , mirpo ja fati i qytetarve që kjo ëndërr u bë realitet që shkolla e mesme në Saraj të filloj procesin edukativo – arsimor në këtë vitë shkollor. Iniciator të themelimit janë komuna Saraj bashkë me disa qytetar dhe intelektual arsimdashës si dhe profesor të shkollave të mesme që kjo komunë te këtë vatrën e vet të dituris që sot quhet Shkolla e mesme e qytetit të Shkupit Saraj. Arsimimi dhe edukimi, të përvetësuarit e njohurive dhe shkathtësive të reja si dhe edukimi janë prioriteti ynë. Ne do të prodhojmë gjenerata të reja të arsimuara, por edhe do të krijojmë personalitete të suksesshme, krijuese dhe moderne. Përveç kësaj, gjeneratat e nxënësve tanë, do të kenë njohuri për moralin dhe etikën e lartë si dhe me sjellje të mirë dhe humane. Ne besojmë fuqimisht në vizionin tonë të brezave të ardhshëm, pra nxënësit të cilët në të ardhmen do të jenë të gatshëm të përballen me sfidat e shoqërisë moderne, të cilat nga dita në ditë kaplohen me turbullira dhe konflikte të ideve, mendimeve, njohurive dhe informacioneve të reja.

Arsimimi dhe edukimi, të përvetësuarit e njohurive dhe shkathtësive të reja si dhe edukimi janë prioriteti ynë. Ne prodhojmë gjenerata të reja të arsimuara, por edhe krijojmë personalitete të suksesshme, krijuese dhe moderne, personalitete që në këtë shoqëri dinamike realizohen, krijojnë vepra dhe tregojnë rezultate e suksese. Përveç kësaj, gjeneratat e nxënësve tanë, janë të njohur për moralin dhe etikën e lartë si dhe me sjellje të mirë dhe humane.

Ne besojmë fuqimisht në vizionin tonë të "brezave të ardhshëm", pra nxënësit të cilët në të ardhmen do të jenë të gatshëm të përballen me sfidat e shoqërisë moderne, të cilat nga dita në ditë kaplohen me turbullira dhe konflikte të ideve, mendimeve, njohurive dhe informacioneve të reja.

Misioni ynë është "për të përgatitur të rinjtë për sfidat e botës moderne." Shoqëri e hapur, e tregut të lirë, rritja e përparimeve tekniko-teknologjike dhe zhvillimi i shoqërisë informative është vetëm një sfidë për mësimdhënësit e ShMQSh "Saraj" për të krijuar njerëz modern, personalitete të reja me perspektivë dhe kreativ.

ShMQSh "Saraj" - Shkup është institucion që ka një përgjegjësi të lartë shoqërore, prandaj bashkëpunimi dhe partneriteti si dhe ndërtimi i marrëdhënieve me shkollat e tjera, institucionet dhe organizatat është interes dhe sfidë e madhe. Shkolla jonë bashkëpunon me institucionet e Qeverisë, Ministrinë e Arsimit dhe Qytetin e Shkupit në fusha të ndryshme (pranimi i standardeve dhe programeve të reja në arsim, për të krijuar kushte më të mira

për zbatimin e vet dhe sigurimin e hapësirës dhe objekteve teknike, programeve, ndihmat për mësim më të mirë). Gjithashtu, shkolla bashkëpunon me organizatat joqeveritare dhe humanitare, me organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësitë diplomatike, si dhe shkolla dhe institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë Republikës së Maqedonisë.

Ne krijojmë të ardhmen. Në shkollën tonë për vitin shkollor 2020/21 kanë funksionuar 16 paralele në drejtimin gjimnaz , ndahen në disa drejtime:

- drejtimi Matematiko-natyrorë;
- drejtimi Humanitarë-shoqëror dhe
- drejtimi Gjuhësorë-artistik.

Gjithashtu, ShMQSh "Saraj"- Shkup ofron edukim në profilin ekonomik në 8 klasa për

- teknik të ekonomisë
- biznes administrator

ShMQSh "Saraj" - Shkup ka 12 kabinete mësimore, salla e konferencave, biblioteka, zyra e arsimtarëve, katër kabinete për aktivet e arsimtarëve, salla sportive megjithatë, mbetet shumë për të bërë dhe për të modernizuar shkollën. Ekipi i Menaxhimit, arsimtarët me aktivet profesionale dhe stafi teknik i shkollës janë të gatshëm për sfida të reja.

## Kushtet hapësinore për punë në shkollë

Veprimtaria edukative - arsimore në shkollë zhvillohet në një godinë shkollore me 12 klasa, një kabinet CRS me lidhje interneti, bibliotekë, oborr shkollor prej 3500 m<sup>2</sup> me fushë sportive, salla sportive, Zyrë të arsimtarëve, kabinete dhe hapësira të tjera ndihmëse. Këtë vit shkollor e kemi filluar në hapësira të cilat për nga aspekti funksional, estetik dhe higjienik janë në nivel shumë të lartë.

Mësimi zhvillohej në dy ndërrime për vitin e parë dhe të dytë si dhe ndrrimi i dytë për vitet e tretë dhe të katërta.

<b>Numri i përgjithshëm i ndërtesave shkollore</b>	1
<b>Numri i terreneve sportive</b>	1
<b>Numri i kateve</b>	kati përdhësë +1 katë
<b>Numri i klasave</b>	12
<b>Numri i hapësirave ndihmëse</b>	4
<b>Salla Sportive</b>	1
<b>Biblioteka shkollore</b>	1
<b>Mënyra e ngrohjes së shkollës</b>	Derivatet e naftës

## Kushtet materialo-teknike për realizimin e punës edukativo arsimore

Mjetet mësimore janë faktor i rëndësishëm për realizimin e qëllimeve dhe detyrave edukativo-arsimore. Pajisja me mjete mësimore, ndihmesa dhe materiale kontribuon për zmadhimin e aktivitetit të nxënësve, ngritja e nivelit dhe kualitetit të mëimit dhe realizimit të kërkesave, kurse me të edhe për arritjen e rezultateve më të mira.

Shkolla disponon me hapësirë dhe pajisje që i plotësojnë standardet për realizim cilësorë të procesit mësimorë sipas planeve dhe programeve që realizojnë në shkollë. Trendi i furnizimeve të shkollës me pajisje të nevojshme për realizim të mëimit teorik dhe praktik nuk do të ndërpritet, përkundrazi, shkolla edhe më tej do të tentoj që përmes mjeteve të saja dhe mjeteve të tjera të furnizoj dhe modernizoj shkollën.

Tekstet shkollore falas, që do të fitohen për nxënësit nga Qeveria e RMV-së do të përcaktohen për çdo nxënës në veçanti.

Mjetet demonstrative dhe pajisjet tjera	Sasia	Kabineti
Monitor	1	Drejtori, Sigurimi, Video-mbikëqyrje
Printer	1	Drejtori
Lap top kompjuterë	1	Drejtori
Kopjutorë	1	Drejtori
Kopjutorë	5	Sekretar, Pedagog, Psikolog, defektolog dhe Përgjegjës për nxënësit me korespondencë
Lap top kompjuterë	10	Kontabilisti, udhëheqësi i ndërrimit, sekretar, arkatar, pedagog, psikolog, defektolog, Bibliotekist, udhëheqës i çregullt dhe prof. i informatikës
Videoprojektor	13	Në të gjitha klasat
Printer	3	Sekretar, Psikolog dhe Pedagog
Smart tabela	11	Nëpër kabinete(klasa)
Pastrues –i ajrit	13	Nëpër kabinete(klasa)

## Stafi arsimor

Veprimtarinë edukativo-arsimore në shkollë e kanë realizuar 51 profesor, 1 pedagog, 1 psikolog, 1 arkatare, 1 sekretari, 1 defektolog, 1 bibliotekist dhe drejtori i shkollës.

Nga të gjithë arsimtarët janë përgatitur dhe dorëzuar planet tematike dhe globale vjetore. Plani vjetor i punës është përgatitur nga drejtori, pedagogu i shkollës, dhe të gjitha aktivitetet profesionale.

Gjatë vitit shkollor, arsimtarët kanë dorëzuar përgatitjet me shkrim për mësim për të gjitha lëndët. Programi mësimor është zbatuar në të gjitha lëndët. Janë realizuar në total prej 147 ditëve mësimore tek vitet e katërta dhe 159 ditë mësimore për vitet tjera. Përveç mësimit të rregullt, arsimtarët kanë realizuar mësim praktik, plotsues dhe shtesë për nxënësit të cilët janë të nivelit të ulët në të mësuarit, dhe nxënësit të tjerë që tregojnë interesim më të madh për të zgjeruar dhe thelluar njohuritë dhe përmbajtjen në lëndë dhe fusha të veçanta, si dhe pjesëmarrjen e nxënësve në gara. Për realizimin e tyre është bërë një orar i veçantë.

Arsimtarët janë të grupuar në katër aktive profesionale:

- Aktivi i lëndëve shoqëro-ro-humanitare
- Aktivi i lëndëve profesionale
- Aktivi i lëndëve matematiko-natyrore
- Aktivi i gjuhëve dhe letërsisë

**Aktivitetet profesionale** gjatë vitit shkollor i kanë realizuar kryer detyrat dhe aktivitetet e planifikuara në programin vjetor. Në mbledhjet e tyre kanë shqyrtuar dhe analizuar rregullshmërinë dhe suksesin e nxënësve, kanë sugjeruar dhe propozuar masa për të përmirësuar ato; kanë koordinuar kriteret e vlerësimit; kanë bashkëpunuar në përpunimin e testeve për provimet e maturës së shkollës dhe shtetërore.

Në përpjekjet për përmirësimin e procesit edukativo-arsimor janë përfshirë forma grupore, individuale dhe forma të tjera të punës. Gjatë mësimdhënies përveç verifikimit dhe vlerësimit verbal, janë zbatuar edhe detyra kontrolluese, puna me shkrim dhe testet, që janë planifikuar në fillim të vitit shkollor. Kujdestarët e klasave kanë ndjekur suksesin, rregullshmërinë dhe disiplinën e nxënësve, kanë bashkëpunuar me drejtorin, personelin dhe prindërit, përveç takimeve individuale, janë mbajtur katër mbledhje prindore dhe dy mbledhje këshilluese me shërbimin pedagogjik-psikologjik të shkollës. Në mbledhjet e prindërve, prindërit janë njoftuar me kushtet e punës, programin dhe planin mësimor, afatet për zbatimin e mësimit të rregullt dhe shtesë, ditët e pranimit të prindërve nga arsimtarët, suksesin, rregullshmërinë dhe disiplinën në klasë si

dhe çështje të tjera aktuale të tilla si: këshillime me prindërit, furnizimi me tekste shkollore falas, sigurinë fizike, ekskursione nuk janë realizuar shkaku i pandemis, zhvillimet aktuale në shkollat e mesme në Shkup, si dhe në tërë R. Maqedonisë së Veriut. Prindërit përmes këshillave prindore, dhe takimet prind kanë qenë të përfshirë vetë në të gjitha aktivitetet e punës së përgjithshme edukativo-arsimore në shkollë.

**Drejtori i shkollës** ka realizuar detyrat dhe aktivitetet e planifikuara në sipas programit vjetor të punës së shkollës dhe programin e vet të punës si dhe çështje të tjera që dalin nga bashkëpunimi me Departamentin e Arsimit të Qytetit të Shkupit, MASH, BZHA, QSHP, QSHM dhe komunitetin e gjerë. Gjatë vitit shkollor Drejtori së bashku me pedagogun dhe psikologun vizitoi (online) një numër të orëve të mësimdhënies për të monitoruar zbatimin e metodave të mësimdhënies interaktive dhe TIK si dhe aftësive të tjera, që arsimtarët kanë fituar në procesin e zhvillimit të përhershëm profesional, po ashtu ka kryer biseda pedagogjike edukative me arsimtarët. Pas analizimit të vizitave nëpër orë, përfundohet se arsimtarët përdorin metoda interaktive dhe teknologji TIK. Drejtori ka ndjekur dhe ka marrë pjesë në punën e përgjithshme të shkollës: procesin edukativo-arsimor, kushtet materiale-teknike për punë, politikën kadrovike, punën financiare etj.

Këshilli arsimor i paraleleve shqyrton suksesin, rregullshmërinë dhe sjelljen e nxënësve, shqipton masat pedagogjike, bashkëpunon me këshillin e prindërve dhe propozon masa për të tejkaluar problemet me rregullshmërinë dhe disiplinën e nxënësve.

**Këshilli arsimor** i shkollës ka mbajtur 17 mbledhje në të cilat janë shqyrtuar sukcesi, vijimi dhe disiplina e nxënësve, ka shqiptuar masat pedagogjike, lëvdata për nxënësit, ka përzgjedhur nxënësin më të mirë të gjeneratës nga maturantët dhe ka propozuar masa për tejkalimin e problemeve të veçanta, që lidhen me përmirësimin e suksesit, rregullshmërisë dhe disiplinës së nxënësve. Në mbledhje janë shqyrtuar: Raporti vjetor i punës, programi vjetor, rregulloret, ndryshimet e Ligjit për arsim të mesëm, aplikimet, informacione të ndryshme, situata aktuale dhe çështje të tjera. Miratohet vendimi për zbatimin e konkursit të brendshëm për regjistrimin e nxënësve në vitin e parë, Komisioni për zbatimin e konkursit për regjistrim, Komisioni për Maturën Shtetërore dhe provimit përfundimtar, kontrollin e jashtëm të njohurive të nxënësve dhe komisione të tjera.

**Psikologu** ka realizuar aktivitetet e planifikuara të programit të punës, në mënyrë të pavarur dhe së bashku me Drejtorin dhe pedagogun e shkollës ishin në vëzhgim në orët mësimore (Online) dhe kanë kryer punë të tjera dhe kanë marrë pjesë në planifikimin dhe programimin e punës së përgjithshme në procesin edukativo-arsimor, pjesëmarrje në përgatitjen e raporteve statistikore

dhe të tjera, punë pedagogjike-mësimore me mësimdhënësit dhe praktikantëve, punë në komisione, punë në organet profesionale. Kanë mbajtur një numër të madh të këshillimeve individuale dhe grupe diskutime me nxënësit dhe prindërit. Bashkëpunojnë me komunitetin e gjerë, kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në punën e stafit profesional të Qytetit të Shkupit. Psikologu gjatë vitit shkollor ka përfunduar këshillimin e prindërve të nxënësve, që tregojnë pak sukses dhe e ndjekin mësimin në mënyrë të parregullt. Bashkëpunimi me Këshillin e prindërve është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit. Prindërit ishin të informuar dhe të përfshirë direkt në të gjitha aktivitetet e shkollës.

**Pedagogu** ka realizuar aktivitetet e planifikuara të programit të punës, në mënyrë të pavarur në bashkpunim me Drejtorin dhe psikologun e shkollës si prsh. vëzhgim në orët mësimore (online), këshillim me prindër, nxënës, arsimtarët, pjesëmarrje në projektet shkollore dhe kanë marrë pjesë në planifikimin dhe programimin e punës së përgjithshme në procesin edukativo-arsimor, pjesëmarrje në përgatitjen e raporteve statistikore dhe të tjera, punë pedagogjike-mësimore me mësimdhënësit dhe praktikantëve, punë në komisione, punë në organet profesionale. Kanë mbajtur një numër të madh të këshillimeve individuale dhe grupe diskutime me nxënësit dhe prindërit, mbledhje këshilluese me kujdestarët e klasave etj. Bashkëpunojnë me komunitetin e gjerë, kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në punën e stafit profesional të Qytetit të Shkupit. Bashkëpunimi me Këshillin e prindërve është zhvilluar në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit. Prindërit ishin të informuar dhe të përfshirë direkt në të gjitha aktivitetet e shkollës.

**Këshilli i prindërve** ka shqyrtuar çështjet e jetës dhe të punës së shkollës, ka shqyrtuar suksesin, rregullshmërinë dhe sjelljen e nxënësve, ka bashkëpunuar me drejtorin, arsimtarët, pedagogun dhe psikologun e shkollës, ka marrë pjesë në organizimin e nxënësve si dhe me përfaqësuesit e vet kanë marrë pjesë në punën e Këshillit të shkollës. Në të gjitha mbledhjet është shqyrtuar gjendja e sigurisë në shkollë, ku ajo është vlerësuar në një nivel të lartë në sajë të masave të marra, por me rekomandim që prindërit, nxënësit dhe arsimtarët të nxjerrin në pah nevojën për tolerancë më të madhe dhe të respektit të ndërsjellë në mes të të gjitha palëve të interesuara në procesin edukativo-arsimor.

**Këshilli i shkollës**, miratoi: Programin vjetor të punës së shkollës për 2020/2021 raportin vjetor mbi punën e shkollës 2020/2022, Raportin për regjistrimin e inventarit dhe mjeteve dhe gjendjen financiare deri më:31.12 2020, Llogarinë përfundimtare për vitin 2020; miratoj planin vjetor për furnizime publike, draft planin për Financat në shkollë. Ka ndjekur rezultatet e nxënësve, siguroi mbështetje për sigurimin e zhvillimit profesional të mësimdhënëseve si dhe çështje tjeratë përcaktuara në Statutin e shkollës.

**Në Programin vjetor të punës u parashtruan prioritetet e mëposhtme:**

### **PRIORITETET**

- Pajisja në vazhdimësi me mjete teknike dhe pajisjeve ndihmëse;
- Trajnimi profesional i mësimitdhënësve;
- Vazhdimi i aktiviteteve në kuadër të programit "Integrimi i edukimit mjedisor në sistemin arsimor të Maqedonisë së veriut";
- Përmirësimi i rregullshmërisë në paralele, duke ndërtuar një sistem të stimulimit të nxënësve të rregullt në procesin e mësimitdhënies dhe mbajtjen më të saktë të evidencës lidhur me rregullimin pedagogjik të mungesave të nxënësve.
- Përfshirja e prindërve në përmirësimin e arritjeve të nxënësve gjatë gjithë procesit mësues.
- Aplikimi i metodave të TIK dhe interaktive në mësimitdhënie në mënyrë që të përmirësojë ambientin e mësimit, ku nxënësit duhet të përjetojnë atë si një mjedis motivues dhe mënyra interesante për të mësuar;
- Ngritja e nivelit të përgjithshëm të kulturës shëndetësore në mesin e nxënësve.
- Bashkëpunimi më i madh me organizatat tregtare dhe tregun e fuqisë së punës. (Promovimi i shkollës)
- Arsimitarët rregullisht të përdorin teknologjitë informatike në mënyrë që të krijojnë komunikim më të mirë me prindërit dhe nxënësit;
  - (e-ditari)
    - Shkolla ti kushtoj vëmendje për të siguruar burime financiare për të mbështetur personelin mësimitdhënës që të marrin pjesë në trajnim, kongrese, seminare dhe veprimtari të tjera profesionale;
    - Biblioteka e shkollës të pasurohet me literaturë shkencore profesionale;
    - Personeli mësimitdhënës duhet të ndikojë në zgjedhjen e temave dhe formave të zhvillimit profesional në shkollë;

- **Zhvillimi profesional për arsimtarët (trajnim për të punuar me nxënësit me nevoja të veçanta), programet mësimore për nxënësit me nevoja të veçanta;**

Nga inspektimi i ditëve të punës dhe raportet e të gjitha palëve të interesuara në procesin edukativo-arsimor mund të konkludojmë si vijon:

- Planprogrami dhe programet janë zbatuar plotësisht;
- Suksesi i nxënësve në fund të vitit shkollor është solid;
- Nxënësit kanë kaluar me sukses provimet e maturës shtetërore dhe provimet përfundimtare dhe do të mund të vazhdojnë arsimimin e tyre ose që të përfshihen në procesin e punës;
- Është reduktuar numri i mungesave;
- Arsimtarët kanë përdorur metoda të mësimdhënies interaktive dhe aplikimin e TIK-ut në zbatimin e programit mësimor.

### **Kushtet materiale – teknike**

Mësimi është zhvilluar në 13 kabinete nga të cilat 1 janë pajisur me kompjuterë me lidhje të jashtme të internetit, 4 punëtori shkollorë, 1 bibliotekë, oborrin e shkollës 3500 m<sup>2</sup> me fusha sportive, zyra për arsimtarët, kabinete dhe objekte të tjera ndihmëse.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve për realizimin e aktiviteteve edukative, pamjes estetike dhe të klimës së përgjithshme në shkollë gjatë vitit shkollor janë zhvilluar këto aktivitete:

- Çezmat (rubinetet) jofunkionale ekzistuese, janë zëvendësuar me çezma të reja.
- Oborri pjesa e hortikulturës është ndryshuar me mbjelljen e bimëve dekorative dhe lëndinë (barë)
- Riparimin ngjyrosje sipërfaqet e mureve me ngjyrë fasade gjysmë të errët të zgjedhur nga investuesi i saj dhe riparimin e sipërfaqeve të njëjtame llaç mineral me silikon akrilik të bardhë, në të gjitha këndet ndërmjet tavanit dhe mureve të çara, që ndodhen ndërmjet tyre në sipërfaqet e murosura.

## **Punët që janë bërë në shkollë**

Në vitin shkollor 2020/21 janë realizuar këto punë:

- 1.Salla e re sportive
- 2.Pastrimi i ullugjeve në kulm
3. Mirëmbajta e rrethojës së terenit Sportiv
4. Rrethoj e klasave me drasa druri për mbrojtje në klasa
5. Mbjellja e drunjëve dhe bimëve halore
- 6.Mbuloja në para hyrjes së sallës sportive
7. Instrumentet muzikore
8. Projektor
- 9.Smart Tabela
10. Libra-lektyra
- 11.Lyerje e mureve të jashtme të shkollës.
- 12.Kompjutor për kabinetin e informatikës
- 13.Ndryqim në oborrin e shkollës
14. Riparim në shkollë dhe tjera.
- 15.Nmdërtimi i fontanës në oborin e shkollës.
- 16.Paisje me kompjuter dhe llaptop.
- 17.Ndërtimi i kotllarës për nxemje të sallës sportive.
- 18.Rrethoja e oborit të sallës sportive.

## **Bashkëpunimi**

Bashkëpunimi me shkollat e tjera. Shkolla gjatë vitit shkollor ka bashkëpunuar me shkollat e tjera fillore dhe të mesme nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte të përbashkëta, gara etj.

Bashkëpunimi me MASH, Departamenti i Arsimit të Qytetit të Shkupit, BZHA dhe OSHC, për zbatimin me sukses të gjithë punën në shkollë ishte bashkëpunimi i afërt me Departamentin MASH, BZHA, QShP dhe OJF. Vazhduan dhe shkëmbyen shumë raporte, të dhëna dhe informacione të tjera. Ndërsa janë organizuar trajnime dhe seminare.

Bashkëpunimi me Qendrën e Shëndetësisë Shkup - kryhen kontrolla mjekësore dhe vaksinime;

Bashkëpunimi me Ministrinë e Punëve të Brendshme;

Bashkëpunimi me teatrot, QKM, shkolla dhe institucione të tjera;

Bashkëpunimi me programet televizive të mëngjesit MRT dhe ALSAT, si dhe programe të tjera arsimore.

## **Aktivitetet**

\*Dita e Veprimit (aksionit) - Riciklimi i baterive "rritjen e ndërgjegjësimit të veprimit dhe inkurajimin e sistemit të menaxhimit të baterive mbeturina"

\*Maqedonia pa mbeturina – veprimi kryhet në shkollë.

\*21 mars 2020 - Dita e aksionit të të rinjve të mjedisit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

\*U realizua me sukses projekti për një "Qytet më të sigurt" në nivel të qytetit të Shkupit, në bashkëpunim me MPB, sektori për arsim dhe shkollat e mesme të qytetit të Shkupit.

## **Projektet e dramës:**

\*Realizimi i pjesës teatrale „22 nëntori" në kuadër të projektit "Ditët e alfabetit të gjuhës shqipe" patronati i shkolles (online).

\*Realizimi i pjesës teatrale „28 nëntori" në kuadër të projektit "Ditët e flamurit shqiptar "(online).

\*Performanca Faza-muzikore,, Shkupi kujton" mbajtur më:05.05.2019 ., si pjesë e projektit të Qytetit të Shkupit,-Shkup, me titull të njëjtë, Shkupi kujton" për të shënuar 53 vjetorin e tërmetit në Shkup;

\*Realizimi i programit „ 7 Marsi "në kuadër të projektit" Ditët e mësuesve shqiptarë "në bashkëpunim me shkollat e tjera në Shkup.

\*Dita ekologjike

### **Ekskursionet**

Gjatë vitit shkollor janë realizuar dy ekskursionet një ditore, me karakter kulturor, argëtues dhe me karakter rekreativ.

### **Puna shoqërore e dobishme dhe për të promovuar shëndetin e nxënësve**

Në kuadër të veprimeve të dobishme shoqërore, aksionet mjedisore nxënësit kanë marrë pjesë në rregullimin e oborrit të shkollës dhe të klasave.

Për zbatimin e përmbajtjes në fushat për të mbrojtur dhe promovuar shëndetin e nxënësve janë kryer kontrolle mjekësore për nxënësit e vitit të parë, vitit të dytë dhe të tretë për vaksinimin kundër fruthit. Nga Instituti për mbrojtje shëndetësore të nënave dhe fëmijëve u organizuan ligjërata në temat: Parandalimi i varësive; Sëmundjet seksualisht të transmetueshme (SIDA). Për nxënëset e vitit I, II dhe të III janë organizuar ligjërata edukative për higjienën personale të organeve riprodhuese.

### **Aktivitetet e bashkësisë së nxënësve të shkollës**

Këtë vit 2019/2020 bashkësia e nxënësve pranë ShMQSh. "Saraj", ka vepruar në mënyrë aktive jo vetëm në shkollë, por edhe në komunitetin më të gjërë. Në takimet e rregullta mujore është diskutuar mbi segmentet e ndryshme të jetës shkollore të nxënësve, rolin e tyre në vendimmarrje në shkollë dhe përfshirjen e tyre aktive në zhvillimin e komunitetit lokal. Nxënësit tonë kanë marrë pjesë në shumë gara të ndryshme: komunale, rajonale, republikane dhe ndërkombtare, ku kanë pranuar shumë mirnjohje, kanë zënë vendin e dytë në volejbol meshkujt, vendin e dytë në futboll meshkujt dhe femrat. Në Paris dhe Çikago nxënësit e kësaj shkolle morën pjesë në film me metrash të shkurtër dhe në Stamboll në rok – festivalin ndërkombtarë.

Bashkësia e nxënësve të shkollës ka organizuar:

- Aksione humanitare ndihmë për familjet e varfura.
- Bashkëpunim me kryqin e kuq të RMV-së.
- Aksion pastrimi në nivel Komunal.

## Statistika e përgjithshme për katër në fund të vitit shkollor 2020/21

Nr.	Viti	Numri I nxënësve	Meshkuj	Femra	Nx.që kalojn Pastër	Nxënësit Me të dopta	Nota Mesatare	Mungesat të arsyeshme	Mungesat të pa arsyeshme	Mungesat gjithsej
1.	I	191	94	97	110	72	3.00	3228	1094	4319
2.	II	187	86	101	128	58	2.82	3899	1474	5583
3.	III	179	79	100	122	26	3.05	1946	1111	3057
4.	IV	189	55	134	189	0	3.38	1759	769	2468
5.	Gjithsej	746	314	432	549	156	3.06	10832	4448	15427
								14.5 mung. Për kok nxënës	mung. Për kok nxënës	20.7 mung. Për kok Nxënës

- Shikuar në tërsi , mund të jemi të kënaqur nga suksesi i fund vitit shkollor 2020/21,shikuar mesatarja e suksesit për vitin e parë **3.00**, për vitin e dytë **2.82. për vitin e tretë 3.05** si dhe për vitet e katërta me notë mesatare **3.38** kurse nota mesatare në nivel të shkollës **3.06**. Nga rezultat i më sipër vimë në përfundim se duhet më tepër përkushtim , punë, nëse duam të arrijmë rezultate më të mira për vitin e ardhshëm.

KRYETAR I KËSHILLIT TË  
TË SHKOLLËS  
SHMQSH “ SARAJ“-SHKUP

**Arlind Baku**

---

